



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE**

---

---

**VENDIM**

**Nr. 3, Datë 01.04.2010**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani          | Kryetar    |
| - Z. Bashkim Sykja         | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar     |
| - Znj. Ledina Mandia       | Anëtar     |
| - Z. Altin Goxhaj          | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2010, mori në shqyrtim publicitetin “*Flisni pafundësisht me të gjithë numrat Albtelekom, vetëm me 500 lekë në muaj*” pjesë e fushatës publicitare të operatorit Albtelekom sh.a, Megjithëse operatori Albtelekom sh.a është njoftuar për fillimin e procedimit administrativ si dhe është ftuar të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit me shkresë nr.prot 3, datë 25.03.2010, nuk u paraqit asnjë përfaqesues i tyre.

Komisioni pas shqyrtimit të rastit,

**VËREN SE:**

Ky publicitet është i ndaluar, duke u konsideruar si praktikë e padrejtë tregtare, referuar nenit 15, pika 1, sipas të cilit “*Një praktikë tregtare është çorientuese kur, duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, jep të mangët informacionin, që i nevojitet konsumatorit mesatar për të qenë i informuar për të marrë një vendim dhe, në këtë mënyrë, e bën apo ka mundësi ta bëjë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë*”.

**Ky publicitet është i ndaluar, duke u konsideruar si praktikë çorientuese, referuar nenit 15, pika 4/c,** sipas të cilit “*Në rastin e një ftese për blerje, nëse kjo nuk është e qartë nga konteksti, do të konsiderohet si thelbësor informacioni i mëposhtëm:*

*çmimi, që përfshin edhe taksat, ose mënyrën në të cilën llogaritet çmimi, kur natyra e mallit ose shërbimit është e tillë që nuk mundëson llogaritjen e arsyeshme paraprake të çmimit dhe, sipas rastit, të gjitha shpenzimet shtesë për transportimin, dorëzimin apo shpenzimet postare ose faktin e pagimit të shpenzime të tilla suplementare, kur ato nuk mund të llogariten arsyeshëm paraprakisht*”;

Në rastin në shqyrtim, publiciteti për thirrjet telefonike në të gjithë numrat altelekom kundrejt tarifës fikse prej 500 lekë në muaj nuk përfshin TVSH-në, duke dhënë një informacion të mangët në publik, corientuar konsumatorin dhe ndikuar që ky i fundit të marrë një vendim të gabuar në lidhje me ofertën.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni mbështetur në nenin 15, pikat 1 dhe 4 (c), si dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/b të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

**VENDOSI:**

Operatori Altelekom sh.a të ndeqë shkeljen menjëherë nga marrja e njoftimit në lidhje me këtë vendim të Komisionit..

**KRYETAR I KOMISIONIT**

**ANILA JANI**